



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:113557

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06081010

C.nr.2729/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B. M. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson avokati E.Q. nga Prishtina sipas autorizimit bartës nga avokati S.K. nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Obiliqit, të cilën e përfaqëson avokati B.C. nga Prishtina, me autorizim bartës nga avokati Nazim Mehmeti nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimin e pagës mbi bazën e kualifikimit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, në të cilën të pranishëm ishin përfaqësuesit e palëve, me datë 23.08.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B. M. nga Prishtina, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit që paditëses në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit – fakultet për periudhën kohore nga data 01.06.2019 - 06.02.2023, përkatësisht për 44 muaj, nga 55.35 euro për secilin muaj, t’ia paguajë shumën prej 2,435.40 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 02.06.2022 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 259.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 02.06.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagës mbi bazën e kualifikimit.

Paditësja, në padi, si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se është e punësuar në ShFMU “/” në Obiliq dhe është me kualifikim – fakultet, ndërsa paga bazë e saj për periudhën e kërkesës ka qenë 421 euro, ndërsa për këtë periudhë paditësja në emër të kualifikimit ka pranuar shumën mujore prej 58.32, edhe pse i ka takuar shumën prej 113.67 euro në muaj. Kështu, në seancën e shqyrtimit kryesor, e ka rregulluar, përkatësisht ndryshuar padinë në aspektin objektiv, ashtu që ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B. M. nga Prishtina, dhe të detyrohet e paditura Komuna e Obiliqit që paditëses në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit – fakultet për periudhën kohore 01.01.2019 – 06.02.2023, përkatësisht për 49 muaj nga 55.35 euro për secilin muaj t’ia paguajë shumën prej 2,712.15 euro, me kamatë

ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 17.12.2021 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 259 euro.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigje në padi dhe në seancë gjyqësore e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, për arsye se e paditura nuk është nënshkruese e kontratës kolektive të datës 18.04.2017, në të cilën e bazon kërkesëpadinë paditësi, e rrjedhimisht kjo kontratë nuk mund të ketë implikime financiare për të paditurën, por vetëm për palët nënshkruese, ndërsa sa i përket gjendjes faktike ka deklaruar se për ta nuk është kontestuese gjendja faktike, por vetëm baza ligjore. Po ashtu, sipas të paditurës, kërkesa e paditëses pas ndryshimit të sotëm nuk është e parashkuar.

Gjykata për ta vërtetuar sa më saktë dhe drejtë gjendjen faktike, administroi provat materiale si: Kontrata e punës e datës 25.01.2016; Diplomë e datës 20.06.2011, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës dhe Lista e pagave.

Pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, përkatësisht përfaqësuesve të tyre gjykata erdhi në përfundim se nuk ishte kontestuese gjendja faktike se paditësja është e punësuar në ShFMU “/” në Obiliq dhe është me kualifikim – fakultet, ndërsa paga bazë e saj për periudhën e kërkesës ka qenë 421 euro, ndërsa për këtë periudhë paditësja në emër të kualifikimit ka pranuar shumën mujore prej 58.32.

Kjo gjendje faktike edhe pse jkontestuese, ishte në përputhje të plotë me provat e administruara më sipër.

Gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqëse kontestuese është vetëm baza ligjore lidhur me kërkesën e paditësit.

Sa i përket bazës ligjore, gjykata vendimin lidhur me kërkesën për kompensim në bazë të kualifikimit e ka bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), në të cilin është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendësdrejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10% të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me një ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, në këtë rast, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses pagën sipas përqindjes në përputhje me kualifikim - fakultet, për periudhën 01.06.2019 - 06.02.2023, pasi siç u konstatua më sipër paditëses i është paguar vetëm pjesërisht shuma për kualifikim, gjegjësisht 58.32 euro për periudhën 01.06.2019 - 06.02.2023, për 44 muaj, ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, paditësja është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro, që do të thotë se e njëjta për këtë periudhë nuk është paguar edhe 55.35 euro në muaj, e që kjo shumë për 44 muaj është e barabartë me shumën prej 2,435.40 euro, dhe kështu gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t’ia paguajë këtë shumë për kërkesën për kompensim mbi bazën e kualifikimit.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës të parashtruara në seancë, gjykata vlerëson se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla nuk paraqesin bazë për refuzimin e kërkesëpadsisë së paditëses, për shkak se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses lidhur me kompensimin e pagës mbi bazën e kualifikimit edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratave Kolektive të Arsimit, të vitit 2017 dhe 2021, pasi që lidhur me këtë kërkesë baza ligjore qëndron në vendimin e lartcekur të Qeverisë së Kosovës, i cili është i detyrueshëm për të paditurën.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës gjykata u bazua në Rregulloren për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, dhe Udhëzimin Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore. Shuma prej 259 euro konsiston në shpërblimin për përpilimin e padisë në shumë prej 104 euro, një seancë gjyqësore prej 135 euro dhe 20 euro në emër të taksës gjyqësore.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.2729, datë 23.08.2024

Gjyqtari,
Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate.